



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 524, datë 03.11.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Thomaidha Roça, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal”.

**GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata dhe Tonin Sterkaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Person i tretë: {...}, etj.; Objekti: “Rishikim vendimi”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Rishikimi i vendimit civil i formës së prerë me nr.10-2021-641 (225), datë 06.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Për veprën penal parashikuar nga neni 130/a/1 dhe 321/2 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi (relatore), Arta Duka dhe Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}; Objekti: “Pavlefshmëri kontrate, sigurim padie, etj.”

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka (relatore), Sonjela Voskopi dhe Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}etj; Objekti: Detyrim njohje investitor.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani (relator), Arta Duka dhe Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Pushim cenimi në pronësi”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: Subjekti {...}; Të paditur: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: Rivendikim sendi, sigurim padie, etj.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Njohje pronësie”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: Këshilli i Ministrave; Të paditur: {...}, {...}, etj.; Objekti: “Detyrim njohje pronar, pavlefshmëri vendimi, etj”.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës{...}; Të paditur{...}, etj.; Objekti: “Njohjen e të drejtës së pronësisë, etj.”

### **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1.Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri (relatore), Genti Shala dhe Valdete Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro (relatore), Valdete Hoxha dhe Elbana Lluri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**